



Npi – 01/321 datë: 26.09.2025

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores së Punës të Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/155 të datës 27.04.2023, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më 26.09.2025, është nxjerrë:

E K S T R A K T **P R O C E S V E R B A L**

I Mbledhjes së -IX- të rregullt, të Kuvendit të Komunës së Shitimes,
e mbajtur më datën 26.09.2025 (e premte), në ora 10:00h, në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, i cili, pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi, anëtarët e Kuvendit: z.Besnik Seferi, z.Asllan Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu, z.Gëzim Haxhiu, z.Kadri Emini, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Ademaj, z.Artan Lubovci, z.Rrahman Jakupi, z.Lumni Amrush, znj.Besartë Musliu-Spahija, z.Hasan Avdyli, znj.Albana Podvorica, znj.Adelina Beqaj, z.Reshat Mujota, z.Rexhep Gashi.

Përveç anëtarëve të Kuvendit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtorat, z.Grejtalb Emini – DPUKGJ, z.Bardhyl Rushiti – DSHP, z.Besnik Ahmeti – DBF, znj.Mimoza Salihu-Qeriqi – DSHMS, z.Imri Hoxha - DAP, znj.Gentiana Mehmeti, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit, znj.Vlora Hysenaj, Zyrtare për Informim. Praktikantja, znj.Hava Llugaxhiu. Për këtë seancë kemi propozuar këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 25.08.2025,
2. Draft – Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2026,
3. Propozim - Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2024 në vitin 2025,
4. Raporti periodik për zbatimin e Raportit të Auditorit,
5. Prezantimi i Planit Buxhetor Komunal 2026 – 2028 (pas diskutimit publik),
6. Pyetje – Përgjigje.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Kadri Emini: Përshëndetje. Sa i përket rendit të ditës Buxheti nuk duhet të jetë pikë e rendit të ditës, siç e dini edhe zyrtarisht ne jemi në fushatë zgjedhore dhe konsideroj se votimi i këtij Buxheti do të jetë goditje për demokracinë. Kështu që unë propozoj që të shtyhet kjo pikë. Duhet të ju sqarojmë edhe qytetarëve që pasojë juridike nuk ka afati përfundimtar për votimin e këtij Buxheti ku është data 31 Dhjetor. Ne si anëtarë të Kuvendit jemi duke jetuar në një Republikë demokratike dhe duhet të punojmë fortë që ky Shtet të jetë sa më demokratik, dhe kërkojë nga anëtarët tjerë mbështetje që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një mbledhje tjetër.

z.Besnik Seferi: Përshëndetje. Mendoj që një gjë e tillë nuk duhet të ndodhë, që dy mandate jam asambleistë në këtë Kuvend një gjë e tillë asnjëherë nuk ka ndodhë, dhe mendoj që nuk kemi mundësi dhe as kohë, duke marrë parasysh që këto projekte janë në të mirë të qytetarëve të

Komunës, dhe ky buxhet është përpiluar në mënyrën më të mirë të duhur. Diskutimet publike kanë përfunduar të gjitha. Ne si grup parlamentar jemi që të vazhdojmë me këtë pikë të rendit të ditës.

z.Muhamet Ademaj: Përshëndetje. E përkrahu rendin e ditës sipas propozimit të Kryesuesit.

z.Reshat Mujota: Përshëndetje. Faktikisht sa i përket planit buxhetor, diskutimi publik veçse është përfunduar. Jam këmbëngulës që të përfshihen kërkesat e qytetarëve, nëse nuk përfshihen kërkesat e qytetarëve dhe kuvendarëve, po pajtoj edhe unë që të shtyhet kjo pikë por nëse përfshihen të gjitha kërkesat dhe mundem me përpilu atëherë mund të jetë pikë e diskutimit. Kisha dashtë një sçarim të plotë nga Kadriu, nëse ka sçarim pajtoj me propozimin e tij.

z.Kadri Emini: Çështja është që unë nuk e kontestoj çështjen e renditjes apo kodet buxhetore por unë e kontestoj si proces, për shkak se seanca është dashtë me u thirrë pak para se të fillojë fushata zgjedhore, kështu kanë vepru edhe shumica e Komunave të tjera. Konsideroj që është goditje e demokracisë, prandaj i qëndroj prapa propozimit të mëhershëm.

z.Rexhep Gashi: Përshëndetje. I dëgjova parafolësit. Unë kisha kërku përsëri nga parafolësi se a kemi ndonjë pengesë juridike apo jo? Pse nuk jeni konsultuar me ekzekutivin që mbledhja të bëhet para se të hyjmë në fushatë zgjedhore? Gjatë diskutimit të kësaj pike duhet të ndalemi dhe ta diskutojmë nuk është nevoja ta shtyjme. Ky Kuvend ka fillu pa parime dhe vetëm për çështje personale, siç kam thënë është çerkuz dhe e them prapë.

z.Kadri Emini: Mendoj që isha i qartë. Sipas opinionit të Rexhës e shoh që është “Për” votimit të Buxhetit, gjë që është në rregull. Rexha e tha që në këtë Kuvend nuk janë marrë vendime të mira, nuk e di që ky Kuvend ka marrë ndonjë vendim të keq. E thashë që ndonjë pasojë juridike nuk ka, vetëm votimi i Buxhetit në proces të fushatës është goditje për demokracinë. Qytetarët nuk dënohen me mos votimin e këtij Buxheti. Ky Buxhet implementohet në Mars e tutje, deri atëherë do të votohet.

z.Rexhep Gashi: Parafolësi paragjykoj atë çka tha dhe e ka me të drejtë, sepse jam “Për” me kalu Buxheti, unë asnjëherë nuk kam qenë “Kundër” Buxhetit, por kam qenë “Kundër” proceseve që kanë dalë në projekte. Dy Buxhete tjera nuk i kam kaluar arsyet ua tregova. Njëherë kam qenë jashtë vendit dhe nuk më keni jap fjalën që të flasë on-line, ku ligjërisht ka pas asambleistë këtu që e kanë gëzuar këtë benefitet që të flasin prej Zvicerës.

z.Asllan Beqaj: Përshëndetje. Deshta me ja dhënë një arsytim të shkurtër Kadries, unë them që është plotësisht demokratike sepse ky proces nuk ka filluar në muajin Shtator por më herët në Qershor, dëgjimet publike kanë përfunduar. Këto janë kërkesa të qytetarëve e jo kërkesa tona personale.

Është shumë ligjore dhe demokratike sepse ne e kemi ende mandatin 4 vjeçar nuk na ka skaduar ende, besoj që duhet të vazhdojmë plotësisht me këtë pikë të rendit të ditës, pastaj kur të vijë pika e rendit të ditës diskutojmë për secilën çështje.

z.Muhamet Ademaj: Me vëmendje e ndëgjova Rexhepin kur tha që nuk është i kënaqur me punën që e kemi bërë ne si koalicion, e ndjejë vetën shumë krenar për të gjitha projektet që kanë qenë në interes të qytetarëve e që unë i kam votuar, ne jemi këtu të thirrur për me punuar për interesa të qytetarëve e jo me i bllokuar projektet. Po e shoh që qytetarët janë falenderues për punët e mira që i ka bërë ky koalicion.

znj.Adelina Beqaj: Përshëndetje. Mendoj që duhet të shtyhet kjo pikë, dihet që është një Buxhet i fushatës ku juve ju ka konvnuar politikisht që me sjellë, por edhe arsye tjetër është që na ka ardhur me vonesë materiali. E mbështes propozimin e LDK-së, që kjo pikë të shtyhet.

z.Reshat Mujota: Fatkikisht po kthehemi në vitin 2021, ku e kemi marrë një buxhet të trashëguar. Edhe në fshatin tim më është drejtuar gishti, duke thënë ky nuk e ka kaluar Buxhetin duke bërë politikë. Kur janë arritur qëllimet e veta nga koalicioni, ka kaluar buxheti edhe pa votën e opozitës. Te kërkesat që kërkoj me u përfshi në Buxhet ka pas çështje më të rëndësishme dhe nuk janë përfshi. Ato projekte që janë në interes duhet të përfshihen në Buxhet, nuk po them të gjitha. Nëse këtë Buxhet e keni me bërë fushatë pajtoj me u shty ky Buxhet. Propozoj 5 minuta pauzë që të konsultohen shefat e grupeve parlamentare.

znj.Zejniye Veliu: Përshëndetje. Dua të lidhem rreth rendit të ditës, ka disa muaj që është punuar në këtë Buxhet dhe janë mbledhur kërkesat e qytetarëve dhe pikërisht nga kërkesat e qytetarëve është bërë edhe Buxheti. Nuk e shohë të arsyeshme të shtyhet kjo pikë dhe në fund të mandatit të i zhgënjejme qytetarët.

z.Besnik Seferi: Fakt është që ne e kemi deri më 31 dhjetor afatin. Është një procedurë që neve na obligon me patjetër që Komuna duhet ta dorëzojë projekt-buxhetin te Ministria e Financave deri më 30 shtator. Ka ndodhë që edhe në seancat e kaluara të shtyhet dhe mos të votohet. Duhet të i japim kahje aprovimit të këtij Buxheti, sepse është në të mirë të të gjithë qytetarëve.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Në vitin e kaluar Buxheti ka kaluar në afat në Shtator. Në vitin 2023 jo vetëm që nuk ka kaluar Buxheti por edhe është tentuar me u bllokuar Kuvendi me ngarkime dhe shkarkime. Ky Buxhet është për vitin 2026. Ka Komuna që Buxhetin e kanë kaluar dje, por ka që do ta kalojnë edhe sot e nesër. Nuk ka të bëjë kjo fare as me demokraci dhe as me fushatë. Është obligim ligjor që ky Kuvend të miratojë Buxhetin në Shtator. Unë i falenderoj asambleistët që kanë marrë pjesë në dëgjime publike. Pajtohem me Reshatin kur tha që nuk mundën të gjitha kërkesat me u përfshi në Buxhet por vetëm ato më prioritare. Ne mund ta lejojmë me votë Buxhetin që të kalojë në legjislaturën tjetër ky Buxhet. Nuk dihet se kur do të formohet Kuvendi, nëse mendoni në mos aprovimin e këtij Buxheti, me ja humbë qytetarëve 600 mijë euro atëherë urdhëroni ngriteni dorën dhe thoni se po e heqim po e shtyjme buxhetin të gjithin, me 30 Shtator Buxheti duhet me u dërguar te Ministria e Financave. Nëse nuk votohet rrezikohen edhe pagat e zyrtarëve të Komunës në vitin e ardhshëm. Kjo është në dorën tuaj se a dëshironi me e shty apo me e votu, qytetarët na shohin. Ju bëjë thirrje pa dallim që ta votoni Buxhetin dhe rendin e ditës. Po bëjmë 5 minuta pauzë mundë të vazhdojmë pastaj.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Vazhdojmë në ora 11:29h, jemi pak me vonesë. Le të vazhdojnë shefat e grupeve parlamentare, pas konsultimeve të bëra.

z.Besnik Seferi: Atëherë siç e potencova edhe më herët ne si grup parlamentar jemi që kjo pikë të jetë pikë e rendit të ditës.

z.Kadri Emini: Ne ju qëndrojmë prapa pretendimeve tona qysh në fillim kështu që vazhdojmë tutje.

z.Reshat Mujota: Unë sinjerisht me keqardhje po e them, mirëpo kësaj rradhe do ta përkrahi Kadriun. Siç shihet numrat nuk mund ti ketë ky pushtetë për ta votuar, dhe të themë të drejtën deshta me shfrytëzu që kësaj radhe të hyjnë kërkesat e qytetarëve të cilat për 4 vite nuk kam mundur me i përfshi në asnjë Buxhet kur i ka pasur pushteti numrat. Kështu që qëndroj pas propozimit të Kadriut.

z.Rexhep Gashi: Te propozimi i LDK-së unë nuk e fajësova. Mbi të gjitha partneri i koalicionit tuaj kërkoj që të shtyhet, dhe e arsyetuan në takimet 5 minuta që i patëm se pse të shtyhet. Unë mendoj se kemi hapsirë që ta shtyjme. Kërkesat shumë jetike që ka pas te ujësjellësi dhe kanalizimi nuk ishin përfshirë. Në qofëse na jepet hapësira mundemi me shty.

z.Muhamet Ademaj: Unë veq e ceka më herët që e përkahu rendin e ditës me planin buxhetor. Po kërkojë edhe nga kolegët e mi që me Buxhet nuk duhet me bërë lojra, por duhet të votohet sepse mund të ketë pasoja në nivesime kapitale dhe për paga të punëtorëve që punojnë nëpër institucione publike.

z.Gëzim Haxhiu: Përshëndetje. Ne si përfaqësues duhet të jemi më racional ta shohim se a është më mirë për qytetarët që kjo pikë të shtyhet, kështu që unë jam pro që të jetë pikë e rendit të ditës.

z.Asllan Beqaj: Nuk ka bazë me u shty kjo pikë. Dëgjimet publike janë mbajtur në kohë, kërkesat e qytetarëve janë të përfshira në Buxhet, nuk ka diçka që e cenon demokracinë prandaj edhe po kërkojë që secili prej këtyre asambleistëve të mos i ik përgjegjësisë po le ta votojnë si rend dite e pastaj te diskutimet kemi çka me diskutuar secili. Që 4 muaj është duke u diskutuar ky Buxhet.

z.Kadri Emini: Çështja e Buxhetit nuk duhet të jetë politike, më duhet me sçaru prap. Buxheti hartohet mbi bazën e kërkesave prioritare të qytetarëve. Cenimi i demokracisë është nëse i propozojmë kërkesat në bazë të numrit të votave që i kemi. Afati ligjor është data 31.12.2025 ka afatë të mjaftueshëm deri në atë periudhë. E themë publikisht nëse nuk votohet deri në dhjetor

edhe pagat e administratës nuk dalin unë kurrë më në jetë nuk merrem me politikë. Ne nuk tërhiqemi nga propozimi ynë.

z.Asllan Beqaj: Kadri, thae po bëhet politikë me Buxhet. Buxhetet e kaluara i kemi kaluar bashkë me juve LDK-në dhe me secilin prej asambleistëve. Ka asambleistë tjerë jashtë koalicionit që kanë përfshi këtu projekte, secili projekt që ka qenë në interes të qytetarëve ka kaluar. Politika po bëhet nga ju dhe jo nga ne.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Duhet ta hedhim në votim rendin e ditës ashtu siç e keni marrë, dhe nëse nuk kalon vazhdojmë me propozimin për largimin e pikës 5. Konstatohet Kuorumin prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 8 vota “Për”, me 10 vota “Kundër”, dhe me 0 vota “Abstenim”, nuk e miratoi rendin e ditës, të propozuar nga Kryesuesi i Kuvendit.**

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 10 vota “Për”, me 8 vota “Kundër”, dhe me 0 vota “Abstenim”, miratoi rendin e ditës pa pikën 5 si vijon:**

1. **Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 25.08.2025,**
2. **Draft – Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2026,**
3. **Propozim - Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2024 në vitin 2025,**
4. **Raporti periodik për zbatimin e Raportit të Auditorit,**
5. **Pyetje – Përgjigje.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 25.08.2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, me 17 vota “Për”, me 0 vota “Kundër”, dhe me 1 votë “Abstenim”, miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më: 25.08.2025.**

Pika 2

Draft – Rregullore për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2026

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Siç edhe e dimë kjo Rregullore shkon në diskutim publik. Në Komitetin për Poliktë dhe Financa si dhe Komitetin për Komunitete rekomandimet janë që kjo pikë e rendit të ditës të shkojë në diskutim publik.

z.Reshat Mujota: Jam “Për” që të kalojë kjo pikë e rendit të ditës pasi që shkon në diskutim publik.

z.Besnik Seferi: Jemi “Për” edhe ne si grup parlamentar që të vazhdojë në diskutim publik. Po dua ta potencojë vetëm një gjë, sinqerisht me keqardhje po e themë për partnerët tanë të koalicionit, që për 4 vite ishim bashkë dhe qeverisëm bashkë e sot të vihet në një vendim të tillë që të mos aprovohet Buxheti kjo po më duket jo e mirë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Ju kisha lutë që të mos dilni nga rendi i ditës, e respektoj dhe e vlersojë secilin anëtarë që merr vendim me dorën e tij, arsyet e veta i dha gjithësecili.

z.Kadri Emini: Nuk duhet të keqpërdoret foltorja e Kuvendit për interesa personale politike. Nuk ke propozimi i PDK-së, por propozim personal i imi, PDK-ja është pajtuar me atë mendim ne nuk e bëmë në dakordim me PDK-në një veprim të tillë, është mendim i imi personal.

z.Muhamet Ademaj: Edhe unë e përkrahu që kjo pikë e rendit të ditës të shkojë në diskutim publik.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatohet kuorumin prej 18 anëtarëve prezent në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në Diskutim Publik, Draft-Rregulloren Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2026. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria Komunale për Buxhet dhe Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim.**

Propozim - Vendim për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2024 në vitin 2025

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën ja dha z.Besnik Ahmetit.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Përshëndetje. Shuma që e kemi sjellë për bartje është si pasojë se pasi që i kemi mbyllë pasqyrat financiare i kemi pasur dy transaksione të cilat i kemi pasur kthim nga Thesari, njëra ka qenë ekzekutim i një vendimi gjyqësor të kontratës kolektive ku Thesari e ka marrë gabimisht te ne në Komunën e Shtimes e që ka qenë 6,239.70 euro dhe tjetra 270 euro që ka qenë një dënim te pylltaria, të cilat Thesari i ka kthyer e që kanë ardhë pas mbylljes së pasqyrave financiare. Ne e dimë që të hyrat e bartura i kemi dërgu në muajin Maj, mirëpo kjo shumë ka ardhur pasi që janë mbyllur të gjitha raportet e që duhet me ardhë edhe njëherë në Kuvend në mënyrë që të mos mbetet për vitin tjetër. Këtë shumë prej 6.509.70 euro e kemi propozuar me shku në një projekt kapital, te projekti i rregullimit të shtigjeve të ecjes në Gllavicë, pasi që një shumë të këtij projekti e ka ekzekutuar Thesari për vendime të kontratës kolektive.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Të dyja Komitetet kanë rekomanduar që kjo pikë të kaloj, këto janë vetëm dy bartje të vogla që do të bëhen për shkak të kontratës kolektive siç e tha edhe Drejtori.

z.Reshat Mujota: Kur po vjen puna te të barturat po thoni që është bartje e vogël me 6 mijë euro, por në Buxhet kemi projekt me 5 mijë euro. A e përmbyll kjo shumë atë projekt apo jo? Të jepen specifika, do të jem "Për" nëse e finalizon atë projekt.

z.Muhamet Ademaj: E përkrahu bartjen e të hryave, shumën nuk qenka edhe aq e madhe 6 mijë euro është ardhë nga propozimi i ekzekutivit, kështu që e përkrahu.

z.Rexhep Gashi: Është shumë e madhe dhe jo e vogël. Te alokimi dhe investimi te Gllavica duhet me dërgu ende para për me investu, e keni lënë anash pak, kërkesa kemi pasur çdo herë nga qytetarët. Gabimet e tua drejtor janë pasojë e keqëqeverisjes Aliu. Ky dokument është dashtë me ardhë më i kompletuar. Gllavicës i duhen edhe më shumë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Komuna e Shtimes 100% e ka transparencën në financa. Në Gllavicë ka pasur investime gjatë tërë mandatit, dikund 15 rrugica në Gllavicë janë të përfunduara, ka ndriçim dhe po bëhet një park modern, dhe prapë do të ketë investime. Në Shtime ka projekt edhe 12 milion euro jo vetëm 5 mijë euro, nuk po du me hy në fushatë këtu por të flasim për pikën e rendit të ditës.

z.Rexhep Gashi: Në Shtime nuk mundeni të themi që nuk ka rrugica të shtruara, ka oborre e rrugica të shtruara. Nuk jam kundër asfaltëve, vetëm kualitet duhet të ketë. A ka kanalizim lagja Pjetërshtica në Gjyrkoc? Pjetërshtica nuk ka as kanalizim e as ndriçim, as Zborci nuk ka ndriçim. Operatorët a kanë punuar mirë apo jo përgjegjësitë i kanë menaxherat e kontratave, e jo unë e ti këtu.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Nuk jam menaxher i kontratave. Ku ka kanalizim e ku nuk ka nuk është punë e imja. Ta përfundojmë këtë seancë që është e fundit për këtë mandat e pastaj qytetarët e vlersojnë.

znj.Zejnije Velu: Përshëndetje. Është mirë të ceket që kjo shumë prej 6 mijë eurove gabimisht nga Thesari i shtetit është marrë. Jam që këto mjete të kalojnë te një projekt për rregullimin e shtigjeve në Gllavicë. Gjatë këtij mandati në Gllavicë kemi bërë mjaftueshëm. Po më vjen çudi nga disa kolegë asambleistë kur e kanë mandatin e tretë dhe ende e cekin kanalizimin, ujësjellësin e gjëra të tjera. Zotëri sa e keni ngritur ju zërin për kanalizim e ujësjellës në kohën që keni qenë asambleistë?

z.Rexhep Gashi: Ekzekutivi po të ishte në nivel siç duhej, paraja nuk do të shkonte te Thesari. Deri sa je opozitë je një zë i heshtur. 4 vite mandat nuk janë pak me zgjedhë problemin e kanalizimit dhe ujësjellësit.

znj.Zejnije Velu: Më vjen keq me ndëgjju prej disa njerëzve që thonë ti nuk i din gjërat, i di apo jo besimi i qytetarëve mua më ka sjellë këtu. Protagonisti i këtij cirkuzi je ti që e ke thënë prej fillimi për këtë Kuvend.

z.Rexhep Gashi: Qe një vit e gjysmë ke ardhë, dhe ke ardhë me një shpërblim e që është një ditar. Qe 12 vite unë e kam ngritur zërin, e di ku janë e ku nuk janë funksionale këto projekte.

znj.Zejnije Veliu: Nuk po du me repliku më për hirë të qytetarëve e lë këtë debat, qytetari na njeh, qytetari e dinë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatohet kuorumi prej 19 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht miratoi Vendimin për ndarjen e të hyrave të bartura nga viti 2024 në vitin 2025.**

Pika 4

Raporti periodik për zbatimin e Raportit të Auditorit

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën ja dha z.Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Përmes kësaj seancës e kemi obligim ligjor që në bazë të Ligjit për Zyrën Kombëtare të Auditimit që me datën 30 Shtator me njoftu Zyrën Kombëtare të Auditimit lidhur me ecurinë e rekomandimeve të cilat kanë rrjedhe nga raporti i auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2024. Në vazhdim lexoi materialin, (shih dokumentin).

z.Reshat Mujota: Uroj që të mos kemi përsëritje të këtij raporti, rreth këtij raporti i kam shprehur pakënaqësitë e mia. Kisha kërku që në të ardhmen të mos ketë auditim të kualifikuar. Jam "Për" këtë raport. A kanë mbetë si projekte të pa kaluara te prokurimi a si është çështja? Ka gabime dhe gjetje, kërkojm si kuvendarë që sa më parë ekzekutivi të rregullojë këto gjetje.

z.Besnik Ahmeti, DBF: Sa i përket vonësive lidhur me projektet kapitale është për shkak të vendimeve gjyqësore të kontratës kolektive ku i kanë prishë disa projekte. Është i kualifikuar pra për shkak të kontratës kolektive. Prapë do të jetë i kualifikuar ky raport edhe në 2026 edhe 2027.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Konstatohet Kuorumi prej 15 anëtarëve prezent në mbledhje.

***Kuvendi i Komunës së Shtimes, unanimisht, miratoi Raportin Periodik për zbatimin e Rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm.**

Pika 5

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Fjalën ja dha znj.Rrezartë Ramadani.

znj.Rrezartë Ramadani: I falenderoj qytetarët për besimin që ma kanë dhënë para 4 viteve, po ashtu edhe kolegëve nga pozita dhe opozita për respektin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë. Siç dihet kur regjistrohen fëmijët në klasë të para ata vaksinohen është obligim ligjor dhe deshta të dijë se si ka shkuar ky proces dhe a ka pasur refuzim për marrjen e kësaj vaksine?

z.Reshat Mujota: Faktikisht unë pyetje nuk do të bëjë por secilin asambleistë dua ta falenderoj për bashkëpunimin. Jam falenderues që asnjëherë në personale nuk ka kaluar me asnjë, kemi bërë debate për çështje konkrete. I uroj secilit asambleistë suksese, le të zgjidhet ai që përfaqëson dhe që kontribon për Komunën tonë.

z.Muhamet Ademaj: E kam një pyetje për Kryesuesin a ka pengesa ligjore që me kërkesën e disa anëtarëve të Kuvendit të thirret mbledhje e jashtëzakonshme më datën 29.09.2025, me një pikë të rendit të ditës aprovimi i Planit buxhetor 2026-2028? I falenderoj të gjithë anëtarët për bashkëpunimin, ata që janë në garë ju dëshiroj shumë suksese.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për mua personalisht seancat e rregullta përfundojnë sot. E kisha shqyrtu mundësin për ndonjë mbledhje urgjente që është për të mirën e qytetarëve. Më vjen keq me potencu por Buxheti mbetet të miratohet në legjislaturën e ardhshme.

znj.Adelina Beqaj: Me bërë pyetje sot ekzekutivi veqse shpërndahet. Në përfundim të kësaj legjislature dua të shprehë mirënjohjen time më të sinqertë për mbështetjen që e kam marrë nga qytetarët, të cilët kenë qenë arsyeja pse unë kam vazhduar me punu. Një falënderim shkon edhe për kolegët të cilët pavarësisht mendimeve të ndryshme politike po besoj që kemi punuar për një qëllim d.m.th për qytetarët e Komunës sonë. Këto sfida mua më kanë forcuar në mbrojtjen e interesit publik, trasnaprencës dhe përgjegjësisë. Sot ndihem krenarë që kam dhënë një kontribut me zërin tim, punën time duke qenë ndër gratë më aktive në Kuvendin Komunal. Sot jam përsëri në garë që të vazhdojmë së bashku këtë rrugëtim për një Shtet më të mirë. Faleminderit edhe një herë mirupafshim në legjislaturën tjetër.

znj.Albana Podvorica: Sot është seanca e fundit, dua të shprehë një falënderim për të gjithë qytetarët e Shtimes. Çdo shqetësim, sygjerim të shprehur nga ju për mua ka qenë motivi për të punuar me përkushtim. Një falënderim shkonë për të gjithë anëtarët e Kuvendit për bashkëpunimin, dhe ju urojë suksese pa dallim. Ky mandat ka qenë një përvojë e vlefshme për mua duke kontribuar në arsim, rini, kulturë dhe sport po ashtu një urë e bashkëpunimit që besojë do të vazhdojë tutje. Çdo sfidë më ka bërë më të fortë për të vazhduar angazhimin tim për Shtimen dhe qytetarët e saj. Ky mandat normalisht që nuk është fundi por një motiv për të vazhduar përkushtimin tim ndaj Komunës sonë. Faleminderit edhe njëherë nga zemra gjithë qytetarëve të Shtimes, suksese për të gjithë.

z.Gëzim Haxhiu: Në seancën e fundit shprehi mirënjohjen time për besimin bashkëpunimin dhe përvojën e çmuar që kam ndarë me ju gjatë këtij mandati. Ka qenë një rrugëtim me sfida por me përmbushje të përgjegjësisë përballë qytetarëve që na besuan. Ndiem krenar që pata mundësin të jap kontributin tim brenda aftësive të mia në vendimmarrje dhe të jem zëri i qytetarëve, dhe të angazhohem në të mirën e përbashkët. Faleminderit kolegëve për bashkëpunimin dhe ju urojë suksese të gjithëve që janë në garë përsëri.

z.Asllan Beqaj: Një falenderim të veçantë për të gjithë ju qytetarë për besimin që na keni dhënë gjatë këtij mandati. Bashkë kemi bërë shumë punë të mira dhe kemi shtyrë shumë procese përpara. Faleminderit të gjithë kolegëve që kemi gjetë bashkëpunimin që me i shty këto procese përpara, por uroj që edhe legjislatura e ardhshme të jetë më bashkëpunuese e kur bëhet fjalë për projekte në të mirë të qytetarëve mos me i blloku por me i shty përpara ato projekte.

z.Besnik Seferi: Ka qenë sfidë ky mandat dhe dua të i falenderoj të gjithë qytetarët e Komunës së Shtimes, meqenëse është seanca e fundit ashtu si në të gjitha mandatet fjalën time e dhashë vetëm në interes të qytetarëve, vazhdojmë me të tretin mandat me të njejtin përkushtim.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Dua të ju jap informacion për të gjithë mandatin që e kemi bërë si Kuvend. Gjatë këtij mandati kemi miratuar 20 rregullore, 31 Plane, mbi 250 Vendime, 3 Deklarata, 27 Konkluzione, 24 Raporte të Kryetarit dhe Ekzekutivit, nga të gjitha këto e kalojnë numrin prej 350. Ky Kuvend ka punuar për të mirën e qytetarëve, ka nxjerrë vendime të mira. Ju kërkoj falje qytetarëve për të gjitha ato që nuk kanë dashtë me i pa në këtë Kuvend, dhe ju urojë që kandidatët për asamble që janë në këtë sallë të kenë suksese, dhe urojë që në mandatin tjetër të ecin punët mirë dhe mbarë në interes të qytetarëve. Dhe i falenderoj edhe të gjithë asambleistët që tash nuk janë në listë për kontributin që e kanë dhënë dhe mirupafshim në mandatin e ardhshëm.

Pasi që diskutime të tjera nuk kishte, mbledhjen e përfundoi në ora: 13:10h.

Procesmbajtëse
Sadberë Halili





Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

